
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

25.03.2026

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “**KRIJON**” SHPK, me NUIS: **K12023001A**, me adresë: *Tirane
Farke FARKE Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak, 1044.*

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mallra.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: REF-75622-02-09-2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje kite, reagente dhe materiale për laboratorin e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pogradec”, me fond limit: 10,527,378 (dhjetë milion e pesëqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë PA TVSH, me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit:17.03.2026

¹Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr. 20 datë 24 Mars 2026

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. OE “BIOCHEM NRP” SHPK

K31404135W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: 7,895,534 (shtatë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) lekë **pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. OE “KRIJON” SHPK

K12023001A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: **7,895,533.5** (shtatë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre pikë pesë) lekë **pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. OE “ISOMETRIC” SHPK

L92207009A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: **8,832,780** (tetë milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë **pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “BIOCHEM NRP” SHPK

Emri i plotë i shoqërisë

K31404135W

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: 7,895,534 (shtatë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) lekë **pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet e skualifikimit;

- A. Nga vlerësimi i Autorizimeve, kataloget dhe certifikatave të konformitetit të paraqitura nga OE në SPE rezulton se dokumentacioni është paraqitur në gjuhën angleze dhe I përkthyer në gjuhën shqipe, I shoqëruar me vërtetim përkthimi dhe pa I njehsuar me origjinalin sipas përcaktimeve në ligjin nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar i cili në nenin 129 parashikon:

Neni 129

Vërtetimi i njësisë me origjinalin

Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, të dokumenteve të publikuara, si dhe të çdo dokumenti tjetër, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre.

2. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njësuar me origjinalin.

3. Kur dokumenti i paraqitur ka shënime, korrigjime, shtesa, fshirje ose shenja të tjera të veçanta, noteri bën njësimin dhe i pasqyron ato në vërtetim. Në vërtetim pasqyrohet edhe nëse dokumenti origjinal është grisur, dëmtuar apo në ndonjë formë tjetër duket i dyshimtë në pamjen e tij, përveç kur kjo duket qartë nga kopja e dokumentit origjinal.

4. Në rastin e kopjeve të shkurtuara, noteri sqaron nëse pjesët e hequra kanë ndonjë lidhje për pjesët e paraqitura të aktit.

5. Në rastin kur dokumenti është në gjuhë të huaj noteri bën vërtetimin e njësisë me origjinalin, duke kërkuar ndihmën e një përkthyesi, ose duke e bërë vetë kryesisht, sipas parashikimeve të nenit 100 të këtij ligji.

Në kuptim të dispozitës së mësipërme, dokumentacioni i paraqitur i cili është ngarkuar në fotokopje duhej të ishte i shoqëruar me vërtetimin e njësisë me origjinalin nga noteri përkatës.

Në konkluzion dokumentacioni i paraqitur nga OE nuk konsiderohet i vlefshëm duke mos permbushur kërkesat për kualifikim të publikuara ne DST:

1.3 Kapaciteti teknik, nënpikat 4,6 dhe 7

4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA për artikujt objekt prokurimi.

6.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skedë teknike/katalogë teknikë për të gjithë artikujt objekt prokurimi ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. Në katalog duhet të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të artikujve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

7.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm për tregtim të pajisjeve mjeksore të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë sipas ligjit 89/2014 datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjeksore”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ne këtë kuptim operatori ka dështuar të përmbushë kriterin e kualifikimit në përputhje me kërkesat ligjore dhe kualifikuese.

B.OE për plotësimin e kapacitetit teknike pikës 2.3.4

4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA për artikujt objekt prokurimi.

Ka parqitur certifikatë CE nga Prodhuesi HEIN HEREZ Medizinalbedarf GmbH në të cilan përcaktohet se kjo CE i përket artikujve:

- Sete për mbledhjen e mostrave bakteriale
- Shtypëse për gjuhën (tongue depressors)
- Mbulesa kirurgjikale
- Tampona pambuku
- Qese për urinën

Dhe jo për artikujt që ofrohen nga ky prodhues në këtë procedurë prokurimi përkatësisht artikujt 1 (Pipeta automatike 100-1000), art.2 (Pipeta automatike 10-100) dhe 7(Pipeta Sedimenti (SR). Pra nga OE nuk është paraqitur *Certifikata konformiteti CE ose FDA për artikujt objekt prokurimi me numër 1,2 dhe 7.*

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme

Për sa më lartë OE skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. OE “**KRIJON**” SHPK

K12023001A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: **7,895,533.5** (shtatë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre pikë pesë) lekë **pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr.____ Datë____ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

[Titullari i Autoritetit /Entit Kontraktor]